



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1113/2 prot.,

Datë 08.05.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË
TJERË

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SAHORA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-97126-03-04-2024, me objekt: “*Blerje elektropompa zhytëse e panele*”, me fond limit 18,000,000 (*tetëmbëdhjetë milion*) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK në procedurën e prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “SAHORA” SHPK me NIPT L91703022T dhe adresë Rruga Komuna e Parisit, Hyrja 2, Apartamenti 30, ap me nr. Pasurie 6/758+2-30, vol nr.59, fq 31, Tiranë.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “VASAA” SHPK me NIPT J62903470T dhe adresë Fier Fier Fier, FIER, L. KRYENGRITJA E FIERIT.

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A.

Adresa: Lagjia: "1 Maji", Rruga: "Tasi Dema" Fier.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi A/2024/4045, datë 07.05.2024 dhe me Nr.1113/2024 Prot., datë 07.05.2024 e operatorit ekonomik "SAHORA" SHPK për procedurën e prokurimit, "Procedurë e hapur" me Nr. REF-97126-03-04-2024, me objekt: "Blerje elektropompa zhytëse e panele", me fond limit 18,000,000 (tetëmbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Fier Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "SAHORA" SHPK SHPK, me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin si edhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK, për të cilin pretendon se nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat "b" dhe "c" të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet se: "Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime."

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "SAHORA" SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

"•Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.1.1 të Kapacitetit profesional, pasi referuar ekstraktit të QKB, nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim".

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon pretendimet e operatorit ekonomik "SAHORA" SHPK që të skualifikohet operatori ekonomik "VASAA" SHPK, për mospërmbushjen e kriterëve nga ky operator ekonomik si më poshtë vijon:

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushjen e kriterëve si më poshtë vijon:

”2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Cilësisë ISO 9906:2012 të klasës 3B; më të lartë ose (ekuivalente me të) mbi komformitetin e standardeve europiane të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë si: SSH EN 809; SSH EN ISO 12100; SSH EN 60034, SSH EN ISO14121; SSH EN ISO 3744.”

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Katalogun e prodhuesit të mallrave, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara.

Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen, ku të vërtetohet që mallrat e ofruar, plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara. Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 08.05.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Gjergj Mersini

Kryetar

Jonaid Myzyri